

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi-Sheholli dhe bashkëpunëtorit profesional Izet Hyseni në çështjen penale kundër të akuzuarit N.U. nga fshati P., Komuna e P. për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.714/17 e dt.07.08.2017 pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 05.03.2019 në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Rukije Sheshivari, përfaqësuesit të dëmtuarës, dëshmitarit dhe të akuzuarit, të njejtën ditë në prani të akuzuarit mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin ndërsa me dt.12.03.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

N.U., nga i ati R. dhe nëna Z., mbiemri i vajzërisë së nënës A., i lindur më *data e lindjes...*, nga fshati P., Komuna e P., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, i martuar, baba i 3 (tre) fëmijëve, sipas të dhënave penale të kësaj gjykate nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovë.

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse:

Më datë 16.01.2016, i pandehuri N.U. me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshëm ka vjedhur energjinë elektrike, duke anashkaluar fazën L1 në njehsorin elektrik dhe ka bashkuar hyrjet daljet, me ç'rast energjia e shpenzuar elektrike nuk është regjistruar fare. Me këtë rast i pandehuri të dëmtuarës KEDS, - Distrikti në Prishtinë, i ka shkaktuar dëme materiale në lartësi prej 134.02 Euro.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

E dëmtuara KEDS, në Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP/II.nr.714/17 e dt.07.08.2017, kundër të akuzuarit N.U. nga fshati P., Komuna e P. për shkak të veprës penale nga neni Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.02.2019, seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 05.03.2019, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Rukije Sheshivari, përfaqësuesi i të dëmtuarës, dëshmitari, dhe i akuzuari.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor i propozoi gjykatës sa i përket dëshmitarit K.M. që të mos dëgjohej i njëjti ka munguar në seancë edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, pasi që ka qenë bashkë me dëshmitarin S.G. në vendin e ngjarjes.

Gjykata me aktvendim aprovoi propozimin e prokurorit të shtetit për heqjen dorë të dëgjimit të dëshmitarit K.M.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor deklaroi: Mbetëm në tërësi pranë aktakuzës, dhe i propozojë gjykatës që në bazë të provave të administruara dhe dëgjimit të dëshmitarit dhe shkresave të lëndës i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës A.M. në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor deklaroi: I bashkëngjitem fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit, gjykata të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I akuzuari në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor deklaroi: Nuk e ndjej veten fajtor, për shkak se nuk e kam keqpërdorë energjinë elektrike, kërkoi nga gjykata që të më liroj nga kjo aktakuzë.

Gjykata gjatë procedurës së provave ka dëgjuar dëshmitarin S.G. si dhe ka lexuar Procesverbalin mbi konstatimin e gjendjes faktike në teren nr. 2122256 i dt. 16.01.2016, fotodokumentacionin nga vendi i ngjarjes, si dhe fatura e lëshuar nga KESCO, në emër dhe në llogari të KEDS DPR17HP20889.

Dëshmitari S.G. në seancën e shqyrtimit gjyqësor për veç tjerash deklaroi: Njehsori elektrik është i vendosur në shtyllë elektrike jashtë shtëpisë së konsumatorit, kapermani është i mbyllur me çelës dhe vetëm punëtorët e KEDS-it i kanë çelësat për të hapur kapermanin, gjithashtu i njëjti pohon se në atë ditë nuk e kemi hasur e as takuar fare të pandehurin duke manipuluar me njehsorin elektrik, kolegu im ka biseduar me dikë por nuk e di kush ka qenë prezent, i cili i ka marrë të dhënat mbi formulimin e procesverbalit sa i përket pajisjeve elektrike.

Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike Nr. 2122265, i datës 16.01.2016, është i formuluar nga dëshmitarët–punëtorët e KEDS-it, në të cilin thuhet se kanë hasur në keqpërdorim konsumatorin i cili ka bërë anashkalimin e fazës L1 ku shihen se hyrjet dhe daljet janë të bashkuara në një pikë, por nuk është i nënshkruar nga i akuzuari N.U., pasi që i njëjti në ditën kritike nuk është takuar fare nga punëtorët – dëshmitarët e KEDS-it.

Nga fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës gjykata nuk ka arrit të vërtetoi asnjë element të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Nga fatura e lëshuar nga KESCO, në emër dhe në llogari të KEDS DPR17HP20889 për rikthimin e humbjeve, në shumën prej 134.02 Euro, gjykata e konsideron se është e padrejtë të ngarkohet pa vendim meritot të gjykatës.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Gjykata ka analizuar dëshminë e dëshmitarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë në këtë çështje penale-juridike nga dëshmia e tij rezulton se nuk është provuar me asnjë provë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka ndërhy në njehsorin elektrik, pasi që dëshmitari pohon se kapermani në të cilin vendoset njehsori elektrik mund të hapet vetëm me çelësa të cilët i posedojnë punëtorët e KEDS-it, i pandehuri në ditën kritike nuk është parë te shtylla elektrike duke manipuluar me njehsorin elektrik.

Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe në favor të tij dhe bazuar në nenin 361 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe deklarimit nga ana e të akuzuarit, ka ardhur në përfundim se nuk ka prova të mjaftueshme, gjegjësisht të besueshme dhe të sigurta se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë ngase nuk është vërtetuar se ka ndërhy në njehsorin elektrik, këtë e vërteton edhe dëshmia e dëshmitarit i cili thekson i pandehuri në ditën kritike për të cilën akuzohet nuk është hasur duke manipuluar me njehsorin elektrikë, kapermani në të cilin vendoset ora elektrike është i vendosur në shtyllë jashtë shtëpisë së të pandehurit dhe i njëjti është i mbyllur me çelës dhe vetëm punëtorët e KEDS-it i posedojnë çelësat, me asnjë provë nuk janë provuar veprimet inkriminuese të akuzuarit, si dhe duke u bazuar në nenin 3 par. 2 të KPPRK-së, ku është përcaktuar mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen konkrete interpretohen në favor të akuzuarit, andaj provat e siguruar nga prokuroria nuk janë të mjaftueshme për ta vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se i

akuzuari N.U. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe në mungesë të provave tjera bindëse vendosi me aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar 1.3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 3 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 par.1 nënparagrafi 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.866/2017 të dt.12.03.2019

Zyrtare Ligjore
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.